



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1341/1Prot.

Tiranë, më 01/10/2018

**V E N D I M**

**Nr. 190, Datë 01/10/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 50, datë 23.04.2018, e Z. A. Ç, ku pretendohet diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ankuesi është punësuar pranë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, në datën 20.03.2005, në pozicionin “specialist hidraulik + monovrator”. Marrëdhënia e punës ka vazhduar deri në datën 01.12.2017, moment në të cilin, nëpërmjet Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Mat, kjo marrëdhënie pune është ndërprerë me motivacionin *“mosparaqitje në punë në mënyrë të përsëritur”*.

Ankuesi thekson faktin se menjëherë pas ardhjes në detyrë të drejtuesit të ri të Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, ndërmjet tyre është lidhur një kontratë pune me afat të përcaktuar 3-mujor, përkatësisht nga data 26.08.2016, deri në datën 26.11.2016. Sipas parashikimeve të kësaj kontrate, nëse nuk bëhej njoftimi 5 ditë para përfundimit të afatit të sipërpërmendur, kjo kontratë mbetej në fuqi edhe për një periudhë tjetër 9 mujore, përkatësisht deri në datën 26.08.2017. Prej kësaj date, marrëdhënia e punës ka vijuar në mënyrë të heshtur. Ankuesi pretendon se për sa kohë, marrëdhënia e tij e punës me këtë shoqëri ka filluar që në vitin 2005, nuk ka qenë e drejtë,

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

lidhja e një kontrate me afat të përcaktuar, por pavarësisht kësaj, ai e ka nënshkruar këtë kontratë pune.

Z. A. Ç pretendon se ai nuk është njoftuar nga punëdhënësi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Punës, si dhe në bazë të dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se në datën e daljes së Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., Mat, ankuesi ka qenë me raport shëndetësor<sup>2</sup>.

Duke iu referuar akteve të tjera të depozituara në cilësinë e provës nga ankuesi pranë Komisionerit, rezulton se ai është diagnostikuar me “sklerozë multiple”, që prej vitit 2013. Si pasojë e kësaj sëmundjeje, ai është detyruar të pajiset herë pas here, me raporte mjekësore, të cilat, ai pretendon se i ka dorëzuar pranë punëdhënësit dhe është paguar sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

**A.** Pas analizimit të informacionit të dërguar nga ankuesi, mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 556/1, datë 27.04.2018, Z. A. L., Administrator i Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesi A. Ç.

**1.** Në përgjigje të shkresës nr. 556/1, datë 27.04.2018, së Komisionerit, Z. A. L., Administrator i Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, dërgoi shkresën nr. 556/2, datë 07.05.2018, nëpërmjet së cilës, e bën me dije Komisionerin se ankuesi ka filluar punë pranë kësaj shoqërie në datën 20.03.2005, me detyrë hidraulik. Kontrata e tij, e fundit, e punës ka qenë me afat 1 vjeçar.

Lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesi, Z.A. L. informon se nga ana e strukturave përgjegjëse të UK sh.a. Mat, është konstatuar se Z. A. Ç nuk është paraqitur në vendin e punës në datat 1, 2, 3, 6, 7, 8, 9, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 30 nëntor 2017, pa asnjë motiv ose shkak të arsyeshëm dhe pa njoftuar përgjegjësin e sektorit apo drejtorin përkatës. Në këto kushte, administratori i shoqërisë ka marrë Vendimin nr. 45, datë 01.12.2017, nëpërmjet së cilit ndërpret marrëdhëniet e punës me motivacionin “*mosparaqitje në punë në mënyrë të*

---

<sup>2</sup> Referuar raportit mjekësor të lëshuar nga QSUT, Nr. i regjistrit E007739, ku rezulton se ankuesi ka qenë me raport mjekësor nga data 22.11.2017, deri në datën 06.12.2017;

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

*paarsyetuar*”. Në shkresën e dërguar theksohet fakti se Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, nuk është dakord për pretendimin e diskriminimit të ankuesit për shkaqe shëndetësore, por theksohet fakti se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me të është kryer si pasojë e mosparaqitjes në punë në mënyrë të vazhdueshme, për një afat 30-ditor.

**B.** Në vijim, në kushtet kur, Z. A. Ç dërgoi disa shkresa të tjera në cilësinë e provës, Komisioneri iu drejtua sërish Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, me shkresën nr. 556/3, datë 29.05.2018, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion mbi çështjet e mëposhtëme:

- Informacion, nëse Z. A. Ç ka dorëzuar pranë Ujësjetllës sh.a. Mat, raportin për paaftësi të përkohshme në punë, të lëshuar nga QSUT, me Nr. Regjistri E 007734, nëpërmjet së cilit, ankuesit i jepen 14 ditë pushim, përkatësisht nga data 22.11.2017, deri në datën 06.12.2017;
- Informacion mbi faktin, nëse ankuesi është paguar nga Sigurimet Shoqërore Mat, për raportin e sipërpërmendur;
- Z. A. Ç ka dorëzuar në cilësinë e provës pranë Komisionerit, kopje të disa raporteve për paaftësi të përkohshme në punë, që i përkasin periudhës 06.12.2017 deri në 27.01.2018, të cilat duke iu referuar dokumentit “Listëpagesë për përfitimet afatshkurtëra” të subjektit Ujësjetllës sh.a. Mat, të dorëzuar nga ankuesi, rezulton se ky i fundit është paguar për ditët e raporteve, të lëshuara për këtë periudhë kohore. Njëkohësisht, referuar vërtetimit nr. 439, datë 14.02.2018, të Agjensisë së Sigurimeve Shoqërore Mat rezulton se Z. A. Ç është paguar për periudhën 06.12.2017 e në vazhdim me raport KLM nga Sigurimet Shoqërore Mat. Pagesat për raportet për paaftësi në punë janë kryer deri në muajin prill 2018. Në kushtet kur, ankuesi është liruar nga detyra nëpërmjet Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Mat, dhe marrëdhëniet financiare të ankuesit janë ndërprerë në datën 01.12.2017, Komisioneri kërkon të disponojë informacion për sa më sipër;

1. Në përgjigje të shkresës nr. 556/3, datë 29.05.2018, së Komisionerit, Ujësjetllës-Kanalizime sh.a., Mat dërgoi shkresën nr. 678, datë 06.06.2018, nëpërmjet së cilës bën me dije se ankuesi nuk është paraqitur në punë përgjatë gjithë muajit nëntor 2017, pa njoftuar eprorët e tij. Lidhur me çështjen e parë, të parashtruar në shkresën nr. 556/3, datë 29.05.2018, e Komisionerit, theksohet fakti se raportet për paaftësi të përkohshme në punë, për periudhën 22.11.2017 deri më 06.12.2017, janë dorëzuar pranë shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, nga ana e Z. A. Ç, në muajin Janar 2018. Mbi çështjen e dytë, Komisioneri informohet se për raportin e sipërpërmendur pagesa është bërë në datën 01.02.2018. Lidhur me çështjen e tretë, të cituar në shkresën e Komisionerit, Ujësjetllës-Kanalizime, sh.a., Mat shprehet se është mbështetur në nenin 21, pika 2, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), për kushtet e përfitimit të të ardhurave për sëmundje.

2. Në vijim, Z. A. Ç ka biseduar në telefon me inspektoren e çështjes, ku ka informuar se ai ka munguar gjatë muajit nëntor 2017, pasi i është dhënë leje verbale nga ana e eprorëve, fakt të cilin ata tani e mohojnë. Ai theksoi faktin se raportet për paaftësi të përkohshme në punë janë dorëzuar menjëherë pas lëshimit të tyre nga strukturat përkatëse të QSUT-së, pranë Shoqërisë UK sh.a., Mat, por ato asnjëherë nuk janë marrë në dorëzim nga personat përgjegjës në momentin e dorëzimit. Z. A. Ç u shpreh se që prej momentit që ai është diagnostikuar me “sklerozë multiple”, për shkak të kryerjes së vizitave mjekësore pranë QSUT-së në Tiranë dhe për shkak të gjendjes së rënduar mjekësore, ka marrë raporte paaftësie në punë në mënyrë të vazhdueshme. Pranë Komisionerit është paraqitur edhe motra e ankuesit, e cila ka theksuar faktin se ajo personalisht është paraqitur për të dorëzuar raportet mjekësore të të vëllait, por marrja e tyre në dorëzim nga personat përgjegjës të shoqërisë UK sh.a., Mat është zvarritur.

C. Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri iu drejtua palëve në proces nëpërmjet shkresës nr. 556/5, datë 02.07.2018, ku i njoftoi për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, që do të zhvillohej në datën 11.07.2018, ora 11:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

Në këtë seancë dëgjimore u paraqit ankuesi A. Ç dhe përfaqësuesi me autorizim i UKM sh.a., Mat, Z. N. M<sup>4</sup>. Të dy palët parashtruan pretendimet dhe prapësimet e tyre në lidhje me çështjen në fjalë.

Ankuesi parashtroi edhe një herë situatën në të cilën ndodhej, duke theksuar faktin se është punonjës pranë Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat që prej vitit 2005 dhe gjatë gjithë kësaj periudhë kohore nuk ka marrë asnjë masë disiplinore. Në vitin 2014, ai u diagnostikua me sklerozë multiple, por pavarësisht kësaj, ankuesi ka vazhduar punën. Që nga momenti i diagnostikimit me këtë sëmundje, ankuesi është shtruar disa herë spital dhe shpeshherë ka marrë raporte për paaftësi të përkohëshme në punë. Në muajin tetor 2017, ankuesi u shpreh se ka qenë me leje vjetore dhe në datën 01.11.2017 është paraqitur në punë. Z. A. Ç u shpreh se në datën 06.11.2017, ai ka qenë sërish present në punë, sikurse edhe në datën 10.11.2017. Për datat 01-22 nëntor 2018 është mbajtur një procesverbal, ku evidentohet fakti se ai nuk ishte paraqitur në punë. Në datën 22.11.2017, ai është shtruar sërish në spital. Në datën 29.11.2017 ka dalë nga spitali dhe eprori i tij i ka kërkuar dorëheqjen. Ai u shpreh se Drejtori i UKM sh.a., ka këmbëngulur që ai të japë dorëheqjen, pasi ka qenë i paaftë për punë. I pyetur nëse ka ndonjë vendim të KMCAP-së nëpërmjet së cilit ankuesi është shpallur i paaftë për punë, Z. A. Ç u shpreh se është duke kryer procedurat përkatëse pranë KMCAP-së, por ende nuk ka një vendim të tillë. Ndërkohë që, në datën 01.12.2017, me Vendim të Administratorit të Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat është larguar nga puna.

Përfaqësuesi i Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, Z. N. M. u shpreh se ankuesi ka qenë njeri korrekt dhe drejtori i UKM sh.a., Mat ka qenë dashamirës ndaj tij, duke i dhënë leje sa herë që Z. A. Ç ka patur nevojë. Ai u shpreh se Z. A. Ç nuk ka njoftuar për mungesat e tij të

<sup>4</sup> Referuar autorizimit nr. 760, datë 10.07.2018, të lëshuar nga Z. A. L., Administrator i UKM sh.a., Mat;

herëpashërshme gjatë muajit nëntor 2017. Ai ka munguar në punë përgjatë datave 01-30 nëntor 2018. Në fund të muajit nëntor 2017, drejtori i ka kërkuar të largohet nga puna, pasi nuk është i aftë për punë. Z. N. M. u shpreh se drejtuesi i UKM sh.a., i ka thënë ankuesit se: “Mund të të mbaj edhe 1 muaj në punë, por s’ të mbajmë dot më”. Ndër të tjera, Z. N. M. u shpreh se vendi i ankuesit është plotësuar, pasi në muajin shkurt 2018, është emëruar një punonjës tjetër.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në dokumentacionin e administruar përgjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 50, datë 23.04.2018, e Z. A. Ç, rezulton se ankuesi është punësuar pranë Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, në datën 20.03.2005, në pozicionin “specialist hidraulik + monovrator”. Në vitin 2014, Z. A. Ç diagnostikohet me sëmundjen “sklerozë multiple”. Referuar Fletëdaljeve të lëshuara nga QSUT, të depozituara në cilësinë e provës pranë KMD-së, rezulton se ai është shtruar disa herë në spital për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Për sa më sipër rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit të Neurologjisë dhe Shërbimit Infektiv, të QSUT-së, në datat e mëposhtëme:

- Referuar Fletë Përmbledhjes së Daljes, së lëshuar në datën 26.12.2014, rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit të Neurologjisë, pranë QSUT-së, në datën 24.12.2014 dhe ka dalë në datën 26.12.2014;
- Referuar Fletë Përmbledhjes së Daljes, së lëshuar në datën 10.11.2015, rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit të Neurologjisë, pranë QSUT-së, në datën 05.11.2015 dhe ka dalë në datën 10.11.2015;
- Referuar Fletë Përmbledhjes së Daljes, së lëshuar në datën 19.01.2016, rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit Infektiv, pranë QSUT-së, në datën 27.12.2015 dhe ka dalë në datën 19.01.2016;
- Referuar Fletë Përmbledhjes së Daljes, së lëshuar në datën 29.04.2016, rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit të Neurologjisë, pranë QSUT-së, në datën 28.04.2016 dhe ka dalë në datën 29.04.2016;
- Referuar Fletë Përmbledhjes së Daljes së lëshuar në datën 27.11.2017, rezulton se ankuesi është shtruar pranë Shërbimit të Neurologjisë, pranë QSUT-së, në datën 22.11.2017 dhe ka dalë në datën 27.11.2017;

Njëkohësisht, ankuesi shpeshherë është pajisur me raporte të paafëtisë së përkohëshme në punë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Gjendja e tij shëndetësore ishte fakt i njohur për Administratorin e Ujësjellës Kanalizime sh.a., Mat, si dhe për kolegët e Z. A. Ç.

Marrëdhënia e punës së ankuesit me U.K.M. sh.a. ka vazhduar deri në datën **30.11.2017**, pasi nëpërmjet Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Mat, kjo marrëdhënie pune është ndërprerë me motivacionin **“mos paraqitje në punë në mënyrë të përsëritur”**. Baza ligjore e vendimit të sipërpërmendur, ndër të tjera, i referohet nenit 156 **“Zgjidhja e menjëherëshme e pajustificuar e kontratës nga punëmarrësi”**, të Kodit të Punës<sup>5</sup>, fakt i cili justifikon mos njoftimin paraprak të ankuesit, për zgjidhje të kontratës së punës.

Pretendimet e Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat, mbështeten fillimisht në në Proçesverbal-Konstatimi nr. 532, datë 21.11.2017, të nënshkruar nga Z. B. C., Shef i Sektorit Hidraulik të Fshatit dhe Z. D. K., Shef i Sektorit të Qytetit. Në këtë proçesverbal të mbajtur në datën 21.11.2017 citohet: **“Për muajin nëntor 2017, punonjësi A. Ç nuk është paraqitur asnjë ditë në punë dhe nuk kemi njoftim për arsyet e mungesave”**. Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se në këtë proçesverbal është shënuar që ankuesi nuk është paraqitur asnjë ditë në punë gjatë muajit nëntor 2017, ndërkohë që data e mbajtjes së proçesverbalit rezulton të jetë **21.11.2017**, pra 9 ditë para përfundimit të muajit nëntor. Komisioneri konstaton gjithashtu se në fund të proçesverbalit është shënuar data **21.12.2017**, datë krejt e ndryshme me atë të shënuar në fillim të këtij proçesverballi. Në vijim, është mbajtur Proçesverbal Konstatimi i datës 01.12.2017, ku sërish konstatohet se ankuesi nuk është paraqitur në punë për muajin nëntor 2017. Gjithashtu në referencë të listëprezencës së muajit nëntor 2018, rezulton se Z. A. Ç nuk është paraqitur asnjë ditë në punë gjatë muajit nëntor 2018.

Ankuesi pretendon se i ka kërkuar leje Administratorit për periudhën 1-6 nëntor dhe ky i fundit, duke qenë në dijeni të gjendjes së tij shëndetësore, i ka dhënë leje në mënyrë verbale për të mos qenë prezent në punë për disa ditë gjatë muajit nëntor 2018, por ky fakt nuk u provua nga Z. A. Ç, ndërkohë që, Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat e mohon një gjë të tillë. Ankuesi ka depozituar në cilësinë e provës pranë Komisionerit, raporte për paaftësi të përkohëshme në punë që provojnë se gjatë muajve nëntor-dhjetor 2017, ai ka qenë me raport për paaftësi të përkohëshme në punë për periudhën **22.11.2017 – 06.12.2017**. Në vijim, ankuesi ka marrë raporte të tjera për paaftësi të përkohëshme në punë, që i përkasin datave 06.12.2017 – 21.12.2017, 21.12.2018 – 05.01.2018, 05.01.2018 – 20.01.2018, 20.01.2018 – 27.01.2018, fakt që dëshmon se gjendja e tij shëndetësore ka qenë jo e mirë. Motra e ankuesit, Znj. B. L., ka lëshuar një deklaratë noteriale nëpërmjet së cilës, deklaroi se është paraqitur në datën 08.12.2018 pranë U.K.M. sh.a. për të dorëzuar raportet për paaftësi të përkohëshme në punë të ankuesit, por këto raporte janë refuzuar të merreshin në ngarkim nga punonjësi përgjegjës. Në vijim, pasi ajo është informuar pranë

---

<sup>5</sup> Neni 156 i Kodit të Punës parashikon: **“1. Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi, për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës nga ana e punëmarrësit. Punëmarrësi duhet të përgjigjet financiarisht ndaj punëdhënësit, jo më shumë se paga e një jave. Ai duhet të përgjigjet edhe për dëmin shtesë, që është diferenca midis dëmit dhe pagës së një jave.2. Gjykata mund të vendosë zvogëlimin e masës së dëmshpërblimit nëse punëdhënësi nuk ka pësuar asnjë dëm ose nëse dëmi është më i vogël se masa e dëmshpërblimit, të parashikuar në paragrafin e mësipërm të këtij neni.3. Kur e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin nuk shuhet me kompensim, ajo parashikohet brenda 30 ditëve, duke filluar nga data kur punëmarrësi nuk ka filluar punën ose e ka braktisur atë.”**

strukturave përgjegjëse të INSIG Tiranë se këto raporte duhet të paguheshin nga U.K.M. sh.a., është riparaqitur duke u bërë me dije personave përgjegjës pranë kësaj shoqërie, bazën ligjore përkatëse<sup>6</sup>, në bazë të së cilës kjo shoqëri duhet t'i merrte në ngarkim dhe t'i paguante ankuesit raportet në fjalë.

Z. A. Ç nuk është paraqitur në punë nga data **01.11.2017 – 21.11.2017**, periudhë për të cilën ankuesi pretendon se i është dhënë leje verbale nga Administratori, ndërkohë që prej datës **22.11.2017 - 06.12.2017**, ai është i pajisur me raport për paaftësi të përkohëshme në punë.

Për sa më sipër, rezulton se Vendimi nr. 45, datë 01.12.2017, i Administratorit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a., Mat është miratuar në një datë, në të cilën ankuesi ka qenë me raport për paaftësi të përkohëshme në punë. Neni 147, pika 1, e Kodit të Punës parashikon: *“1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paaftësie të përkohëshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi.”* Për sa më sipër, rezulton se marrëdhëniet e punës me Z. A. Ç janë ndërprerë gjatë një periudhe kohore, kur ai ka qenë me raport paaftësie në punë, e si rrjedhim është kryer në kundërshtim me parashikimin e mësipërm.

Komisioneri gjykon se pavarësisht se raportet për paaftësi të përkohëshme në punë të Z. A. Ç janë dorëzuar pas daljes së vendimit për zgjidhje të kontratës së punës, Administratori i U.K.M. sh.a. ka qenë në dijeni të gjendjes shëndetësore të ankuesit, diagnozës dhe sëmundjes prej së cilës ai vuante. Ky fakt ishte i njohur prej tij, pasi Z. A. Ç e kishte bërë të ditur gjendjen e tij shëndetësore dhe dorëzonte raporte të shpeshta për paaftësi në punë. Në këtë kontekst, marrja e vendimit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëherëshme nga ana e tij, për një punonjës që ishte në gjendje mjekësore të rënduar, përbën një veprim të padrejtë e disfavorizues për Z. A. Ç.

Komisioneri vë në dukje faktin se pretendimi i ankuesit se Administratori i U.K.M. sh.a. i ka kërkuar dorëheqjen, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, vërtetohet me dëshminë e përfaqësuesit të kësaj shoqërie, Z. Mallunxa, i cili e pohoi një fakt të tillë në seancë dëgjimore. Administratori i UKM sh.a. e ka cilësuar ankuesin të paaftë në punë dhe i ka kërkuar dorëheqjen edhe pse KMCAP nuk është shprehur ende mbi një fakt të tillë.

Një fakt tjetër që dëshmon për një qëndrim të padrejtë dhe disfavorizues për ankuesin lidhet me kontratën e tij të punës. Ankuesi punonte që prej datës 20.03.2005, në pozicionin “specialist hidraulik + monovrator” pranë U.K.M. sh.a. me një kontratë me afat të pacaktuar. Në vitin 2014, ai diagnostikohet me sëmundjen “sklerozë multiple” dhe në vitin 2016, UKM sh.a. lidh me të një

<sup>6</sup> Mbështetur në nenin 21, pika 2, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), për kushtet e përfitimit të të ardhurave për sëmundje.

kontratë të re pune, me afat të caktuar. Në nenin 29 të kontratës citohet: “...Pasi punëmarrësi u njoh me rregulloren e brendshme të institucionit, detyrat dhe kompetencat e tij, të dy palët bien dakord dhe me dëshirë dhe vullnet të lirë miratojnë këtë kontratë pune për një periudhë 3 (tre) mujore nga data **26.08.2016** deri më datë **26.11.2016**. Në mbarim të afatit të mësipërm dhe nëse nuk bëhet njoftimi 5 ditë para përfundimit të afatit të mësipërm, kjo kontratë mbetet në fuqi edhe për një periudhë tjetër 9-mujore deri më datë **26.08.2017**. Në mbarim të afatit të sipërcituar, ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër”.

Për sa më sipër, as ankuesi dhe U.K.M sh.a. nuk kanë paraqitur kontratë të re pune, para Komisionerit, që të vërtetojë që marrëdhëniet e punës së ankuesit me këtë shoqëri të jenë zgjatur tej datës **26.08.2017**. Në këto kushte, rezulton se prej kësaj date, ankuesi ka punuar pa asnjë kontratë punë pranë U.K.M. Mat. Mbështetur në faktet e mësipërme, Komisioneri gjykon se ankuesi ka qenë më herët, i piketuar nga Administratori i U.K.M. sh.a., për të ndërprerë marrëdhëniet e punës. Mosrinovimi i kontratës së punës pa asnjë arsye të justifikuar dhe fakti që ankuesi ka punuar pa asnjë lloj kontratë pune nga data **26.08.2017** deri në datën **30.11.2017**, moment në të cilin, nëpërmjet Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a është larguar nga puna, vërteton në mënyrë të pamohueshme qasjen dhe tendencën aspak pozitive ndaj tij

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesi A. Ç, i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, nga ana e Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Mat.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën nr. 50, datë 23.04.2018, e Z. A. Ç pretendohet diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Ujësjiellës Kanalizime sh.a., Mat.

“Gjendja shëndetësore” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

1. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, Komisioneri gjykon se “gjendja shëndetësore” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo



vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme të depozituara nga ankuesi<sup>7</sup>, që e justifikojnë si të tillë.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

#### **1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjendjen shëndetësore”.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe mbështetur në procesverbalin e seancës dëgjimore rezulton se përfaqësuesi me autorizim i U.K.M. sh.a. është shprehur se Administratori i UKM sh.a. i ka kërkuar dorëheqjen ankuesit pasi ky i fundit nuk është i aftë për punë. Z. N. M. u shpreh se drejtuesi i UKM sh.a., i ka thënë ankuesit se: “Mund të të mbaj edhe 1 muaj në punë, por s’ të mbajmë dot më”. Në gjykimin e KMD-së kjo përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për gjendjen shëndetësore të Z. A. Ç. Qendrimi i padrejtë dhe disfavorizues ndaj të cilit është ekspozuar ankuesi, që lidhet me miratimin e Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a., Mat për zgjidhjen e kontratës së tij të punës është marrë në kundërshtim me parashikimin e nenit 147/1 të Kodit të Punës, si dhe duke u mbështetur në dëshminë e Z. Mallunxa, përbëjnë fakte të pakundërshtueshme për diskriminim të Z. A. Ç, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Z. A. Ç është cilësuar si i paaftë në punë nga Administratori i U.K.M. sh.a., në kushtet kur autoriteti kompetent KMCAP, nuk ishte shprehur ende për një gjë të tillë. Duke e cilësuar të tillë, si dhe duke i kërkuar dorëheqjen, për shkak se vuante nga “skleroza multiple” e ka diskriminuar ankuesin, duke ndërprerë marrëdhëniet e punës në kohë të papërshtatshme.

Njëkohësisht mos rinovimi i kontratës së punës me Z. A. Ç, afati i së cilës përfundonte në datën 26.08.2017, (pas diagnostikimit të tij, në vitin 2014, me “skelerozë multiple”) dhe konstatimi i faktit, se ankuesi ka punuar pa asnjë kontratë pune, me UKM sh.a., nga data 26.08.2017 deri në datën 30.11.2017, është një fakt tjetër përforcues i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore.

Për sa më sipër, mbështetur në parashikimin e nenit 7, pika 1<sup>8</sup>, nenit 12, pika 1, gërma c)<sup>9</sup>, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Z. A. Ç i është nënshtruar një trajtimi diskriminues për shkak të gjendjes shëndetësore.

<sup>7</sup> Raportet për paaftësi të përkohëshme në punë dhe fletëdaljet nga Spitali rezultojnë të kenë të përcaktuar diagnozën “skelerozë multiple”.

<sup>8</sup> Neni 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

<sup>9</sup> Neni 12, pika 1, gërma c), i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim,

## PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, të Z. A. Ç, nga ana e Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a., Mat.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a., Mat, për sistemimin në punë të ankuesit, për sa kohë që KMCAP nuk është shprehur me vendim, që ankuesi është i paaftë për punë.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a., Mat, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

(shkak – gjendja shëndetësore  
Fusha – punësim)

---

*kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

*a) shpalljen e vendeve të lira të punës;*

*b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;*

*c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor **apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**”.*